
Ekonomia shqiptare përballë globalizimit

NELAJ, T.* , LEKSINAJ, E.** , SHEHU, D ***

*Universiteti Bujqësor i Tiranës

PËRMBLEDHJE

Artikulli analizon thelbin e konceptit të globalizimit dhe globalizimin ekonomik si pjesë e tij. Ai është një proces historik dhe vazhdon të thellohet në ditët e sotme. Shumë vende janë integruar në ekonominë globale shumë shpejt, të tjerat po integrohen më ngadalë. Kjo varet para së gjithash nga shkalla e zhvillimit ekonomik. Vendin kryesor në artikull e zë analiza e ekonomisë shqiptare. Mbas ndryshimit të sistemit në vitin 1990, ekonomia kaloi në ekonomi tregu dhe Shqipëria u bë pjesë e ekonomisë me përfshirjen e saj në Organizatën Botërore të Tregëtisë (OBT) në vitin 2000. Mbas këtij procesi ajo filloi të nënshkruajë me vendet e rajonit një sërë Marrëveshjesh të Tregëtisë së Lirë (MTL). Shqipëria i ka nënshkruar të gjitha Marrëveshjet e Tregëtisë së Lirë me të gjitha vendet e Rajonit. Këto Marrëveshje i kanë dhënë efektet e tyre në shkëmbimet tregtare shqiptare ku dominojnë eksportet drejt Kosovës. Në fund të vitit 2006 Shqipëria ka nënshkruar Marrëveshjen e CEFTA-s që është harmonizimi i këtyre MTL-ve në një marrëveshje të vetme dhe më e zgjeruar me vende të tjera të Europës Qëndrore. Gjithashtu, Shqipëria ka nënshkruar Marrëveshjen e Ndërmjetme me BE. Pra me tregtinë e lirë Shqipëria është pjesë e ekonomisë rajonale dhe europiane.

Në artikull jepen të dhëna që tregojnë flukse tregtare rajonale si dhe pozicionin e ekonomisë tonë. Mbas kësaj analize arrihet në konkluzionin se Shqipëria nuk ka përfituar sa duhet nga kjo përfshirje si dhe jepen dhe shkaqet pse ka ndodhur ky proces. Ne shpresojmë që ekonomia jonë do të përfitojë në të ardhmen nga këto marrëveshje.

Fjalë-Kyçe : Globalizim, rajonalizim, ekonomia, shkëmbimet tregtare.

SUMMARY

The article conducts analysis the very essence of globalization concept and economic globalization. It is a historic process and continues to grow deep nowadays. A considerable number of countries have embraced the global economy very rapidly, while the rest are making their way in very gradually. This depends to a large extent on the rate of economic growth. With the radical changes affecting the entire system in the 1990s it's noteworthy to point at that the economy embarked upon the market economy and Albania became an integral part of the economy with its own inclusion under the World Trade Organization in 2000. Albania signing up all Free Trade Agreements with other countries across the region (FTA). These agreements has given their effects in Albanian trade exchanges, where prevails exports to Kosova. At the end of 2006, Albania signing up CEFTA Agreement, which is harmonization of FTA with other countries of Central Europe. Albania signing up Inter Agreement with E.U. too. With free trade, Albania is part of regional and european economy. This analysis renders possible an inevitable conclusion that Albania did not stand to gain much from such agreements. The article does not fail to bring in the reasons as to failure of the process. We hope that our economy will profit in the future, from these agreements.

Key words: globalization, regionalization, economy, CEFTA, FTA.

HYRJJE

Globalizimi është një proces historik dhe që është fryt i inovacioneve humane dhe të progresit teknik. Ai evokon integrim rritës të ekonomive në botë, të shkëmbimeve dhe flukseve financiare, transfertave ndërkombëtare të punës dhe ai përfshin dimensione kulturore, politike dhe mjedisore. Në sajë të globalizimit të tregjeve, mund të ketë akses më shumë për kapitalet dhe resurse teknologjike, që importet janë më pak të shtrenjta dhe që tregjet për eksporte zgjerohen. Globalizimi ofron mundësi të gjëra për një zhvillim të gjerë, por që sigurisht nuk mund të avancojë menjëherë. Shumë vende janë integruar në ekonominë globale shumë më shpejt se të tjerat. Vendet të cilat kanë qënë të afta për t'u integruar, janë zhvilluar shumë tashmë dhe e kanë zvogëluar varfërinë. Përfshirja e ekonomisë shqiptare, në ekonominë botërore, fillon me antarësimin e Shqipërisë në Organizatën Botërore të Tregtisë, në vitin 2000. Mbas viteve 1990, shkëmbimet tregtare shqiptare u orientuan drejt Italisë dhe Greqisë. Me kalimin e viteve, ekonomia shqiptare u orientua dhe drejt tregjeve rajonale, ku dhe mundësia për të depërtuar është më e lehtë sesa në BE. Kështu Shqipëria në kuadër të zbatimit të Marrëveshjeve të Tregtisë së Lirë, ka një bilanc pozitiv vetëm me Kosovën. Shkëmbimet tregtare të Shqipërisë me vendet e rajonit janë të kufizuara. Eksportet e përgjithshme drejt rajonit janë dominuar nga marrëdhëniet me një numër të kufizuar vendesh, si Turqia, Kosova, Maqedonia dhe Kroacia. Duket se MTL-të kanë rritur nivelet e tregtisë dypalëshe midis Shqipërisë dhe vendeve të rajonit gjatë vitit 2009. Volumi tregtar në kuadër të MTL për 2008 zinte 45.6% të shkëmbimeve totale dhe në 2009 kjo shifër është në 56.3% duke shënuar një rritje prej 23.5%. Turqia zë vendin e parë në shkëmbimet në Rajon për 2009. Tregtia në rajon është karakterizuar gjithashtu nga ndryshime në peshën e partnerëve të ndryshëm tregtarë, për të gjetur partnerë tregtarë të rinj e të leverdisshëm.

MATERIALI DHE METODAT

Në kuadrin e rëndësisë së procesit të integritit rajonal dhe europian, qëllimi kryesor i studimit ishte analiza e globalizimit dhe efekteve të tij në ekonominë shqiptare. Kjo analizë do të përfshijë shkëmbimet tregtare

shqiptare në kuadrin e marrëveshjeve të ndryshme si MTL, CEFTA dhe Marrëveshja e Ndërmjetme me BE. Nga kjo analizë kanë dalë konkluzione dhe jepen sugjerime për zhvillimin e ekonomisë shqiptare për të ardhmen. Për të realizuar studimin janë përdorur këto metoda:

Mbledhja e të dhënave statistikore nga Banka e Shqipërisë, INSTAT, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Ministrinë e ndryshme dhe Organizma të huaj.

Intervista: Kjo metodë ishte nga më kryesoret për të marrë informacion mbi problemet që bëjnë objektin e këtij studimi. U bënë intervista me drejtues, të tillë si: specialistët në Ministrinë e ndryshme, si ajo e Ekonomisë, Bujqësisë, etj, si dhe drejtues në Dogana dhe INSTAT dhe në Bankën e Shqipërisë.

REZULTATET DHE DISKUTIMI

Globalizimi lehtëson procesin e integritit në ekonominë botërore dhe e bën atë më pak të kushtueshëm për ekonominë në tërësi dhe kjo në sajë të flukseve të kapitalit, inovacioneve teknologjike dhe uljes së çmimeve të importeve. Vendet me të ardhura të ulta nuk kanë mundur të integrohen në ekonominë botërore me shpejtësi në krahasim me të tjerët për shkak të politikave që ato zgjedhën dhe të një pjese faktorësh të padëshirueshëm nga ato. Komuniteti ndërkombëtar duhet të provojë, nëpërmjet një forcimi të sistemit financiar ndërkombëtar, si dhe në kuadrin e tregtisë botërore, një rritje të ndihmave financiare, të ndihmoj vendet e varfëra për tu integruar në ekonominë botërore, për të përshpejtuar rritjen e tyre dhe për të reduktuar varfërinë. Ky është mjeti më i mirë për t'i lejuar të gjitha vendet të përfitojnë nga globalizimi. Rasti i ekonomive në tranzicion, nga ekonomitë e planifikuara në ato të tregut, tashmë tregon se ato janë bërë më të integruara me ekonominë globale. Disa vende (Polonia, Republika Çeke, Sllovakia dhe Hungaria) janë përshtatur shumë shpejt me strukturën dhe performancën e ekonomive të avancuara. Të tjerat (të tilla, si shumë nga vendet që bënë pjesë në Bashkimin Sovjetik) janë të përballura me probleme institucionale dhe strukturore të ngjashme, me ato që kanë përballur Vendet në Zhvillim. Në vitet e fundit globalizimi ka evoluar shumë, standarti i jetesës është rritur në shume vende. Pra vendet e zhvilluara duhet


që të ndihmojnë vendet e varfëra që të integrohen sa më mirë dhe sa më shpejt në ekonominë botërore, duke reduktuar varfërinë dhe duke u orientuar drejt zhvillimit dhe kjo nëpërmjet forcimit të sistemit financiar ndërkombëtar, përmes tregjeve financiare dhe ato të punës, si dhe të lëvizjes së kapitaleve të huaja dhe inovacioneve teknologjike. Kështu të gjithë njerëzit e rruzullit tokësor do të kishin një nivel jetese më të mirë dhe do

të shijonin frutet e globalizimit. Përfshirja e ekonomisë shqiptare, në ekonominë botërore, fillon me antarësimin e Shqipërisë në Organizatën Botërore të Tregtisë, në vitin 2000. Tregtia shqiptare filloi të funksiononte me rregulla loje dhe e disiplinuar me rregullat e këtij organizmi, ku parashikohen marrëveshjet e OBT-së, të përfshira në Raundin e Uruguajt. Kalimi nga një ekonomi e planifikuar në një ekonomi tregu, bënë që tregtia e jashtme të ishte spontane, me biznese të pakonsoliduara, që ishin të sapo krijuara dhe të sapongritura dhe pa prezencën e Shtetit. Në kushtet e liberalizimit dhe globalizimit, bëhej e domosdoshme ideja e përfshirjes së tregtisë shqiptare në ekonominë ndërkombëtare dhe përshtatjes së politikave të saj tregtare me politikat globale. Sipas të dhënave nga Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe duke zbatuar rekomandimet e tyre, Shqipëria ka tani tregues makroekonomike të qëndrueshëm dhe që është e orientuar drejt një zhvillimi të qëndrueshëm ekonomik, me një inflacion të kontrolluar (në 2009 niveli i inflacionit ishte 2.4%), me një bilanc tregtar të vërtet, që anon nga importi, por, që po vjen duke u përmirësuar, si rezultat i politikave liberale dhe si rezultat i hapjes së tregjeve. Në kuadrin e përfshirjes së politikës së vendit në politikat globale është dhe përfshirja e Shqipërisë në iniciativën rajonale, të ndërmarë në Konferencën e Dohas, në lidhje me bujqësinë. Shqipëria duhet të rrisë pjesën e saj të buxhetit për sektorin e bujqësisë në masën 10 %, dhe kjo në kuadër të hartimit të politikave afatgjatë. Shqipëria ka nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit me BE-në, Marrëveshjet dypalëshe për Tregtinë e Lirë me rajonin dhe ka pranuar nënshkrimin e CEFTA-s. Integrimi i tregjeve bujqësore shqiptare në BE është një prioritet për ekonominë shqiptare. Mbas viteve 1990, shkëmbimet tregtare shqiptare u orientuan drejt dy vendeve fqinj si Italia dhe Greqia. Me

kalimin e viteve, ekonomia shqiptare u orientua dhe drejt tregjeve rajonale ku dhe mundësia për të depërtuar është më e lehtë sesa në BE. Pra, për ekonominë shqiptare kërkohet një hartim i politikave për nxitjen e prodhimit vendas dhe të eksporteve. Shkëmbimet tregtare të Shqipërisë me vendet e rajonit janë të kufizuara. Eksportet e përgjithshme drejt rajonit janë dominuar nga marrëdhëniet me një numër të kufizuar vendesh, si Kroacia, Kosova dhe Maqedonia. Kjo prirje e flukseve tregtare vihet re sidomos në shifrat e importeve. Importet nga Turqia, Maqedonia dhe Kroacia zënë peshën më të rëndësishme në tregtinë me rajonin. Megjithë hyrjen në fuqi të Marrëveshjeve Rajonale të Tregtisë së Lirë, tregtia midis këtyre vendeve është ende në nivele modeste dhe ka rritur shumë pak tregtinë brenda rajonit. Tregtia në rajon është karakterizuar gjithashtu nga ndryshime në peshën e partnerëve të ndryshëm tregtarë. Si rezultat, tregtia është intensifikuar. Sidoqoftë tregtia brenda rajonit është ende në nivelin potencial dhe në disa raste implementimi i marrëveshjeve dypalëshe nuk ka qenë i kënaqshëm. Nevojitet një proces harmonizimi MTL-ve dhe regjimeve rregullatore. Problemet kryesore në implementimin e MTL-ve kanë qenë: zbatimi i procedurave për eliminimin e barrierave jotarifore; egzistenca e asimetrive në kushtet e liberalizimit; implementimi i rregullave preferenciale të origjinës; arritja e standardeve sanitare dhe fitosanitare dhe promovimi i eksporteve bujqësore; aplikimi i qëndrueshëm i klauzolave mbrojtëse dhe zgjidhjeve; përhapja e informacionit mbi mundësitë e reja lidhur me tregtinë dhe investimet. Duke vënë re se tregtia brenda rajonit është ende larg potencialit të saj real, Komisioni Europian inkurajoi dhe u shpreh i gatshëm për të ndihmuar me këshillim dhe asistencë teknike një proces të integritit të rrjetit ekzistues të MTL-ve në një marrëveshje të vetme rajonale të tregtisë së lirë (CEFTA). Ndërkohë që flukset tregtare të vendeve të rajonit janë të orientuara kryesisht nga vendet e BE-së, Shqipëria tregon nivelin më të lartë të përqendrimit tregtar me BE-në si për flukset hyrëse ashtu edhe ato dalëse të mallrave. Për sa i përket importeve, Shqipëria qëndron në krah të Kroacisë dhe Rumanisë me mbi 67% të importeve totale të ardhura nga tregjet e BE-së, nga të cilët katër vende janë partnerë të qëndrueshëm tregtarë të Shqipërisë. Në terma të eksporteve, Shqipëria ka përsëri profilin

tregtar më të përqendruar me BE-në me 86% te volumit total dhe më konkretisht vetëm me dy vende europiane, Italia dhe Greqia. Shkalla e

ulët e diversifikimit të shpërndarjes gjeografike të tregtisë, tërheq vëmendjen drejt eksplorimit të tregjeve të reja.




Source : Drejtoria e pergjithshme e doganave

Figura 1: Eksportet - Importet gjatë periudhës 1993-2009.(ne Mln Lek)

Figure 1: Exports –Imports during periode 1993-2009. (in Mln Lek)

Zhvillimi i sektorit të shërbimeve në ekonominë shqiptare ka çuar në zgjerimin e aktivitetit të tregtisë së shërbimeve me botën, tregues ky i një ekspansioni të hapjes së ekonomisë shqiptare në tregtinë ndërkombëtare. Nga viti në vit, shkëmbimet tregtare kanë ardhur duke u rritur me një rritëm mesatar vjetor 20.8%. Rritja më e vogël në 2009 është 0.6% dhe kjo pasojë e krizës globale dhe uljes së konsumit. Pjesa e eksporteve shqiptare drejt vendeve të BE është 86% e volumit total të eksporteve, ndërsa importet nga BE drejt vendit tonë zënë 67% të totalit të importeve. Referuar grafikut 1 për periudhat e mara në shqyrtim vemë re një ulje të eksporteve në 1997 si pasojë e trazirave që kaloi vendi si dhe në vitin 2000. Ndryshe nga eksportet, importet shqiptare gjatë periudhës 1993-2009 kanë ardhur në rritje. Tendencat në

ulje në 1997 dhe në 2000 janë më të vogla se ato të eksporteve. Në fund të 2009 kemi një ulje të eksporteve me 8% në krahasim me 2008 si pasojë e krizës globale edhe pse që nga viti 2000 eksportet kishin ardhur duke u rritur. Importet gjithashtu janë në rritje por në fund të 2009 kemi një ulje të importeve me 2% si pasojë e krizës. Në dy muajt e parë të 2010 vërehet një përmirësim i ndjeshëm i shkëmbimeve tregtare kryesisht të eksporteve që shënuan një rritje prej 43% krahasuar me janarin e 2009. Këtu ndikuan një rritje e eksportit të naftës bruto dhe energjisë elektrike. Rritja e importeve është më e vogël prej 8% duke ju afruar nivelit të janarit të 2008. Grafiku i mëposhtëm paraqet dinamikën e eksport-importeve të produkteve bujqësore gjatë 2001-2009.



Source : Drejtoria e pergjithshme e doganave

Figura 2 : Eksport-importet bujqesore gjate 2001-2009 (ne Mln Lek)

Figure 2 : Agricultural exports-imports during periode 2001-2009 (in Mln Lek)

Përsa i përket importeve bujqësore, rritjen më të madhe që nga fillimi i periudhës e ka grupi “Kafshë të gjalla dhe produkte me origjinë prej kafsheve” si dhe grupi i ushqimeve, pijeve dhe duhanit. Në 2009 ka një ulje në krahasim me 2008 për” produktet vegjetale” dhe “yndyrnat” ku spikat një ulje e importit të drithrave me 25% si dhe në produktet e industrisë së blojës. Ndërsa në strukturën e eksporteve bujqësore, rritjen më të madhe që nga fillimi i periudhës (2001-2009) e ka patur grupi “yndyrnat shtazore dhe vegjetale” dhe më pas “kafshë të gjalla dhe produktet me origjinë nga kafshët”. Në 2009 krahasuar me vitin paraardhës “produktet vegjetale” rezultojnë me një ulje prej 14% në eksporte dhe 7% në importe, ndërsa grupi “yndyrna” ka një rritje prej 54% në eksporte. Gjatë 2009 si pasojë e krizës Bujqësia pësoi një ulje prej 13% dhe Blegtoaria me 8%. I vetmi sektor që pati rritje në 2009 ishte agroindustria me 19%. Shumë vende zhvillojnë tregtinë me vendet fqinjë ndërsa Shqipëria ka vlera të ulta dhe të kufizuara eksporti me vendet e rajonit. Duhet të stimulohen mundësitë për eksportimin e produkteve shqiptare në rajon dhe të sugjerojë prioritete dhe strategjitë për të ndërhyrë në këto tregje. Numri i vogël i kompanive, infrastruktura e dobët dhe sistemi bankar jo i favorshëm dhe mungesa e lehtësive për kreditim, të gjitha së bashku ndikojnë kundër suksesit të eksporteve si dhe kundër rritjes së pjesëmarrjes në tregun lokal nga kompanitë lokale. Rreth 61% e eksporteve rezultojnë nga veprimtaria e përpunimit për jashtë dhe kjo ndikon në suksesin e dukshëm të eksporteve në BE (86% e totalit), ku pjesa më e madhe e saj është prodhimi nënkontraktues i veshjeve, tekstileve dhe këpucëve për në Itali dhe një nivel më i ulët në Greqi, ku të dyja së bashku zënë 75% të eksporteve për në BE. Në analizën e strukturës së shteteve, në fund të 2009, peshën më të madhe e zënë dy vendet fqinj Italia dhe Greqia përkatësisht me 79.3% në importe dhe 9.3% në eksporte dhe 40.6% në importe dhe 24.2% në eksporte. Ka patur arritje në sektorët e brendshëm si ushqimet e përgatitura, pijet, perimet, lëkurë e papërpunuar dhe produktet minerale, por këto pësuan goditje nga rënia e eksporteve të materialeve të paketuara. Eksportet për në vendet me të cilat Shqipëria ka marrëveshje të tregtisë së lirë janë trefishuar. Pjesa e volumit tregtar që i takon MTL për vitin 2008 zinte 45,6% të shkëmbimeve totale, në vitin 2009

ajo arriti në 56,3% dhe dukë shënuar një rritje prej 23,5%. Turqia zë vendin e parë ku 70% e volumit tregtar zhvillohet me këtë vend në 2009 dhe në kuadër të MTL dhe më pas vijnë Maqedonia, Kroacia, Kosova, etj. Përsa i takon eksporteve bujqësore drejt vendeve të rajonit, vendin e parë e zë Kroacia me 51% të volumit të eksporteve, Mali i Zi me 22% dhe Maqedonia me 17% në vitin 2009. Ndërsa në lidhje me importet, vendin e parë e zë Turqia me 53%, Maqedonia me 19% dhe Serbia me 11%. Volumi i rritjes vjen nga kompanitë e huaja dhe të vendit në fushën e mineraleve dhe metalurgjisë, por ka patur dhe rritje inkurajuese në eksporte nga produktet e vendit përfshirë ujë, produkte perimesh, lëkurët. Për sa i përket përpunimit për jashtë, përjashto produktet lëndë e parë dhe metalet skorje, del qartë se baza e “vlerës së shtuar” e eksportuesve aktualë të vendit është e vogël. Ekonomia shqiptare është përfshirë në ekonominë globale dhe synon që të realizojë përfitime nga globalizimi siç përfitojnë vende si Kina, India, Irlanda, Qipro, Sllovakia, Kili etj.

PERFUNDIME

Pra në përfundim ne nxjerrim konkluzionin ashtu siç e tregon dhe realiteti që shumë vende në zhvillim ku përfshihet edhe Shqipëria, karakterizohen nga institucione jo të forta, sektorët e ekonomisë kanë nivel të ulët kompetiviteti, fuqi punëtore pak të kualifikuar, nivel të ulët të thithjes së teknologjive të reja dhe investimeve të huaja direkte, politika ekonomike të paqëndrueshme dhe pa vizion të qartë afatgjatë, dominimi i koncepteve të subjektivizmit dhe klientelizmit politik dhe ekonomik ndaj respektimit të rregullave bazë të tregut të lirë, etj, bëjnë që ekonomia shqiptare të përfitojë shumë pak nga globalizimi dhe të përfshiht në vendet humbëse në procesin e globalizimit. Produktet shqiptare të eksportuara janë të një shkalle jo të lartë përpunimi, gjë që evidentohet në strukturën e eksporteve ku dominojnë mallra të papërpunuara si nafta bruto, xeherore dhe koncentre kromi dhe hekuri, bimë medicinale, etj. Mbi 63% e eksporteve shqiptare janë dominuar nga industria me fason. MTL-te me vendet e Rajonit dhe CEFTA duket se nuk kanë dhënë rezultatet që priteshin dhe kjo si pasojë e nivelit të ulët të prodhimit, mospërshtatje e kuotave me

produktet më të prodhuara në vend (shpesh kuotat nuk janë shfrytëzuar nga vendi ynë). Del si domosdoshmëri rritja e cilësisë së produkteve, zhvillimi i teknologjive të përpunimit, si dhe konkurrueshmëria e produkteve bujqësore shqiptare duke shfrytëzuar avantazhet konkurruese të Shqipërisë (potencialet e pashfrytëzuara në bujqësi dhe agroindustri). Duke nënshkruar shumë marrëveshje, Shqipëria është angazhuar në proceset integruese ku dhe evidentohen : një përmirësim i ndjeshëm i kuadrit ligjor dhe përafrim i tij me standartet europiane dhe ndërkombëtare, krijimi i institucioneve bashkohore për zhvillimin e tregtisë dhe të biznesit si kërkesë për zbatimin e ligjeve të reja, një qëndrueshmëri në kryerjen e reformave ekonomike, në kuadër të angazhimeve të marra ndaj partnerëve ndërkombtarë, ndërgjegjësim i biznesit lidhur me realizimin e një aktiviteti prodhues dhe tregtar në përputhje me standartet ndërkombtare, etj. Parë në terma absolut dhe relative, shkëmbimet tregtare kanë tendencë rritje. Kjo vjen dhe si pasojë e rritjes së eksporteve që kanë një trend pozitive dhe kjo e

bazuar në importet e makinerive dhe paisjeve, linjave teknologjike për të cilat kanë nevojë industritë prodhuese, investimet e huaja etj. Të gjitha këto hapa pozitive na bëjnë ne optimistë, që në të ardhmen përfitimet e ekonomisë shqiptare do të rriten si pasojë e integritit dhe globalizimit të shkëmbimeve tregtare.

REFERENCAT

BACH, D (1993): ‘*Un ancrage a la derive, la convention de Lome*», Revue Tiers Monde, fq136.

CREMONA, M (1998): ‘The European Union as an International Actor: The Issues of Flexibility and Linkage», European Foreign Affairs Review, Nr 3.

DUNNING, J & HAMDANI, K .A ‘*The new Globalism and Developing Countries*», Fq.155-179.

LEFORT, J. CLAUDE (2000): ‘Rapport sur la place des pays en developpement dans le systeme commercial multilateral», Paris.

Drejtoria e Pergjithshme e Doganave - Buletini i Tregtise se jashtme 2009.